




ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE



Në bazë të nenit 19 të Ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës, nenit 27 të Statutit të Odës Ekonomike të Kosovës, Kryetari i OEK-ut, shpall këtë:

FTESË PUBLIKE

MBI SHPREHJEN E INTERESIT PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË OEK-UT.

SHËRBIMET E AUDITIMIT TË KËRKUARA:

Mbulon të gjitha transaksionet financiare hyrëse dhe dalëse nga llogaritë e OEK-ut, dhe përfshin kontrollet e më poshtme specifike për vitet 2024, 2025 dhe 2026.

- Teston të gjitha llogarit sa i përketë ndershmërisë dhe besueshmërisë së tyre.
- Siguron që asetet dhe burimet financiare janë përdorur konform Ligjit mbi OEK-un dhe rregulloreve;
- Verifikon inventarizimin, llogaritë, pronat dhe pasuritë që janë verifikuar dhe numëruar fizikisht;
- Bënë verifikimin e shpenzimeve dhe dërguesit e deklaratës së shpenzimeve se shpenzimet janë të vërteta dhe të sakta;
- Harton pasqyrat financiare së bashku me raportin e auditimit.

Kualifikimi i Auditorit


- Auditori duhet të jetë krejtësisht i paanshëm dhe i pavarur nga të gjitha aspektet e menaxhimit apo interesave financiare;
- Auditori duhet të jetë një kompani ligjore dhe kredibile e auditimit;
- Auditori duhet të ketë përvojë në auditimin financiar, eksperiencë në këtë fushë të punës dhe të jetë i aftë për të siguruar personel të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për të kryer detyrat e kërkuara.
- Përveç kësaj OEK-u, do të angazhohet edhe vet për të siguruar vazhdimësinë si në metodën e auditimit ashtu edhe në aspektin mbështetës të punës e cila është karakterizuar nga nevoja për të udhëzuar të gjithë stafin përkatës përgjegjës për Administrimin e financave.

Përzgjedhja e auditorit të Pavarur do të bëhet nga ana e Këshilli Mbikëqyrës, pas mbylljes së afatit për aplikim.

Afati i aplikimit është 10 ditë nga dita e publikimit në webfaqen e OEK-ut, www.oek-kcc.org dhe Facebook-un e OEK-ut.

Ofertat të dërgohen në email adresën: Fatmire.Shala@oek-kcc.org ose kopje fizike në OEK.

Oda Ekonomike Kosovës
Kryetar
Lulzim Rafuna



Adresa: Nëna Terezë, Nr:20, 10000 Prishtina – KOSOVË
Tel: + 383 (0) 38 224 741, Tel & Fax +383 (0) 038 224 299
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org